

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj - Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porotë Ismet Këndusi dhe Fahredin Meqa – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të paditësit L. (E.) L. nga Gjakova, Rr. ..., kundër të paditurës B. (Xh.) L. (e lindur H.), nga Gjakova, Rr. “..., për zgjidhje të martesës dhe ruajtje, mbajtje dhe edukim të fëmijëve, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor jo publik, të mbajtur me datë 19.12.2018, në prezencën e palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**ZGJIDHET** martesa e lidhur në mes të paditëses L. (E.) L. nga Gjakova, kundër të paditurës B. (Xh.) L. (e lindur H.), nga Gjakova, e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, me datë ....., nën nr. rendor ..., me nr. të referencës ..., në kuptim të nenit 68 pika 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Fëmijët e mitur të përbashkët të palëve në procedurë O. (L.) L., data e lindjes .... dhe dhe O. (L.) L., data e lindjes . . . , i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim babait të tyre L. (E.) L., ashtu që detyrohet e paditura B. (Xh.) L. (e lindur H.), që t’ia njohë këtë të drejtë paditësit në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

**CAKTOHET** kontakti personal i të paditurës B. (Xh.) L. (e lindur H.), nga Gjakova, me fëmijët e mitur O. (L.) L., data e lindjes... dhe dhe O. (L.) L., data e lindjes ..., të premtën e parë dhe të tretë të çdo muaji nga ora 14:00 deri në ora 15:00, ashtu që ky kontakt realizohet nën mbikëqyrjen e nëpunësit për punë sociale në lokalet e Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë dhe **DETYROHET** paditësi L. (E.) L. nga Gjakova, që fëmijët e lartpërmendur, të i dërgon në lokalet e Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë, në ditët dhe në kohët e caktuara më sipër, e nën kërcënim të përmbarimit.

**DETYROHET** e paditura B. (Xh.) L. (e lindur H.), nga Gjakova, që paditësit L. (E.) L., nga Gjakova, në emër të shpenzimeve procedurale, të ia kompensojë shumën prej 50,00€, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë me datë 20.07.2018, ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës me këtu të paditurën, ashtu sikurse lidhur me besimin, edukimin, ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë. Me tej ka potencuar faktin se: në fillim raportet bashkëshortore kanë qenë të mira, ndërsa në vitin 2018 kanë filluar me probleme të vazhdueshme, me c’rast janë shkaktuar ç’rregullime serioze në marrëdhëniet martesore bashkëshortore, që mund të reflektohen me edukatë të ndryshme, në vështrim të jetës së përbashkët në martesë. Grindjet e përditshme janë shëndërruar në konflikte mjaft serioze dhe të rënda, të cilat kanë marrë karakter të përhershëm, ashtu që jeta e përbashkët martesore është bërë e pamundur. Andaj, nga data 06.05.2018, paditësja e ka braktisur familjen e përbashkët duke u kthyer në familjen e prindërve të saj, ndërsa fëmijët e përbashkët të palëve në procedurë kanë qenë dhe janë në përkujdesje të babait të tyre – këtu paditësit, ku me nënën e tyre kanë shumë pak kontakt edhe përkundër insistimit të paditësit. Në shumë raste kanë tentuar të i rregullojnë marrëdhëniet e tyre, mirëpo një gjë e tillë ka qenë e pamundur.

Paditësi në fjalën e tij përfundimtare deklarojë se: nga të gjitha provat e administruara është argumentuar themelësia e kërkesëpadisë në këtë çështje juridike. Andaj, i propozon gjykatës që të njëjtën si të këtillë t’a miratojë.

Në emër të shpenzimeve procedurale kërkojë taksën gjyqësore për padi.

E paditura në përgjigje në padi, ka parashtruar se: nuk e pranon kërkesëpadinë e paditësit dhe nuk pajtohet që të shkurorezohet, pasi mendon se ende ka mundësi të reja për jetën e përbashkët, nga shkakku se kanë dy fëmijë të përbashkët të cilët janë në një moshë ku kanë më së shumti nevojë për të dy prindërit.

E paditura në fjalën e saj përfundimtare deklarojë se: mbetet në tërësi pranë paarashtrimeve si në përgjigje në padi dhe i propozojë gjykatës që të vendosë në bazë të provave të administruara në këtë çështje juridike.

Nuk kërkojë shpenzimeve procedurale.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve - juridike relevante, çmuarjes me ndërgjegje të provave të zbatuara dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit, e në pajtim me nenin 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u miratua.

Nga provat e zbatuara është argumentuar gjendja faktike si në vijim:

Në mes të palëve ndërgjyqëse është jokontestues fakti se të njëjtit bashkësinë faktike martesore, e kanë shkëputur në muajin janar të këtij viti – 2018 dhe që nga ajo kohë e tutje, jetojnë ndaras.

Nga Certifikatë martese me nr. rendor ... me nr. të referencës ..., e lëshuar me datë ....., në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, rezulton se këtu palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datë ....., në zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile në Gjakovë, me Nr. ser ..., i lëshuar me datë ..., vërtetohet se fëmiju i përbashkët i palëve në procedurë O. (L.) L., ka lindur me datë ....., nga prindërit - babai L. dhe e ëma B. – këtu palët në procedurë.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile në Gjakovë, me Nr. ser ..., i lëshuar me datë ..., vërtetohet se fëmiju i përbashkët i palëve në procedurë O. (L.) L., ka lindur me datë ....., nga prindërit - babai L. dhe e ëma B. – këtu palët në procedurë.

Sa i përket zgjidhjes së martesës në mes të palëve në procedurë, kjo Gjykatë konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 68 par. 1 lidhur me nenin 69 par. 1 dhe par. 2 të Ligjit për Familje të Kosovës (Ligji nr.34/32 i dt.20 janar 2006), meqë martesa e lidhur në mes të palëve në procedurë, e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë, si dhe faktit se : palët në procedurë që nga muaji janar i këtij viti (viti 2018) e kanë ndërprerë bashkësinë faktike martesore. Paditësi jeton së bashku me fëmijët e sipërcekur, ndërsa e paditura jeton tek familja e prindërve të saj. Për këtë arsye gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Nga Raporti i Qendrës për Punë Sociale - Organi i Kujdestarisë në Gjakovë, nën nr. punues ....., i datës ....., është vërtetuar se: në rast se vie deri te zgjidhja e martesës, atëherë fëmijët e palëve në procedurë, duhet të i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim, babait të tyre – pra paditësit në rastin konkret. Organi i lartcituuar, pas vlerësimit të rastit konkret dhe duke u nisur që interesi më i lartë i fëmijëve dhe parësor është se të njëjtit duhet të i besohen paditësit, nga fakti se janë më të lidhur emocionalisht me të, janë duke qëndruar me të dhe i njëjti i ka kushtet më të mira për edukimin, besimin dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë - O. (L.) L., data e lindjes .... dhe O. (L.) L. data e lindjes ....., Ky qëndrim i gjykatës gjenë mbështetje edhe në dispozitën ligjore të nenit 139 parag.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (Ligji nr.2004/32) dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve, për çka u vendos si në pikën II-të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket çështjes së kontaktit të fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë dhe duke pasur parasysh faktin se të njëjtat kontakte të fëmijëve me prindin të cilit nuk i janë besuar në rastin konkret me të paditurën, është në interesin më të mirë të fëmijëve që të kenë kontakte me të dy prindërit, në mënyrë që të kenë një rritje sa më të mirë dhe duke u mbështetur edhe në dispozitën ligjore të nenit 140 par. 3 të LFK-së, të para cituar, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi (pavarësisht nga fakti se palët në procedurë deklaruan se nuk do të ketë problem rreth çështjes së kontaktit të prindit – te i cili fëmijët nuk ndodhen).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar në kuptim të 452 par. 1 të LPK-së me ç'rast paditësit në emër të shpenzimeve procedurale, iu pranua shuma e kërkuar prej 50,00€, e cila i referohej taksës së paguar gjyqësore për padi.

Nga të lartë cituarat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.451/2018 datë 19.12.2018**

**KRYETARI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARI,**  
**Ahmet Idrizaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.